



COVID-19

MASA TË PËRGJITHSHME PARANDALUESE

Rishikuar më 06.04.2020

ESEM | CPT

ENTE UNIFICATO FORMAZIONE E SICUREZZA

Organismo Bilaterale Paritetico costituito da Assimpredi ANCE e Feneal UIL,
Fica CISL, Fillea CGIL per le province di Milano Lodi Monza e Brianza

Sistema Socio Sanitario



Regione
Lombardia

ATS Milano
Città Metropolitana

MASA TË PËRGJITHSHME PARANDALUESE

Kompanitë promovojnë përhapjen e rekomandimeve të përgjithshme për higjienën dhe parandalimin të publikuara nga Ministria e Shëndetësisë edhe duke i ekspozuar në ambientet me më shumë lëvizje dhe në ambientet e hapura për publikun. Për këtë qëllim, mund të përdoren posterat e publikuar në faqen e internetit www.salute.gov.it/nuovocoronavirus.

Ndërmjet këtyre rekomandimeve përfshihen

- ◇ qëndroni të informuar për përhapjen e pandemisë nga burime zyrtare;
- ◇ lani shpesh duart;
- ◇ shmangni kontaktin e afërt me njerëzit që kanë infeksione akute të rrugëve të frymëmarrjes;
- ◇ shmangni përqaqimet dhe shtrëngimet e duarve;
- ◇ në kontaktet sociale, mbani të paktën një metër distancë ndërmjet njëri-tjetrit;
- ◇ higjienë e rrugëve të frymëmarrjes (teshtini dhe/ose kollituni në një façoletë ose këndin e bërrylit duke shmangur kontaktin e duarve me sekrecionet e rrugëve të frymëmarrjes);
- ◇ shmangni përdorimin e shisheve dhe gotave nga shumë persona;
- ◇ mos prekni sytë, hundën dhe gojën me duar;
- ◇ mbuloni gojën dhe hundën nëse teshtini ose kolliteni;
- ◇ mos merrni barna antivirale dhe antibiotikë, përveç rasteve kur janë dhënë me recetë nga mjeku juaj;
- ◇ pastroni sipërfaqet me dezinfektues me bazë klori ose alkooli (duke përfshirë telefonin celular dhe aksesoret).

Kompanitë gjithashtu informojnë punëtorët se nuk mund të hyjnë ose të qëndrojnë në ambientet e kompanisë nëse ekzistojnë kushte të rrezikshme (simptoma, kontakte të afërta me njerëz të konfirmuar si pozitivë në 2 ditët e mëparshme) për të cilat është e detyrueshme të informohen doktorët e mjekësisë së përgjithshme dhe të qëndrojnë në vendbanimin e tyre.

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Udhëzimet e mëposhtme janë hartuar sipas parashikimeve të bazës ligjore në fuqi:

Ju lutemi kontaktoni mjekun e familjes **VETËM** në rastet kur ndihen simptoma të ngjashme me gripin (konjunktivit, dhimbje të fytyrës, ftohje, kollë, temperaturë). Ju lutemi kontaktoni 112 **VETËM** nëse shfaqen simptoma më të rënda gripit të shoqëruara me temperaturë të lartë dhe vështirësi të rënda në frymëmarrje.

PAS PERIUdhës Së Karantinës

Kur kanë kaluar më shumë se 14 ditë nga kontakti i fundit me një rast pozitiv për momentin nuk janë parashikuar masa parandaluese të posaçme, përveç faktit që duhet t'u përbahen rregullave të higjienës të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë në faqen e internetit: www.salute.gov.it/nuovocoronavirus.

UDHËZIME PËR KONTAKTET JO TË DREJTPËRDREJTA

- për ata që nuk kanë pasur kontakte të ngushta me raste të mundshme pozitive të koronavirusit, siç përcaktohet më poshtë;
- për ata që kanë pasur **vetëm kontakte jo të drejtpërdrejta**, p.sh. me një koleg pune të identifikuar si një kontakt i ngushtë me një person që ka rezultuar rast pozitiv;

për momentin **nuk janë parashikuar masa kufizuese ose masa paraprake të posaçme**, përveçse zbatimit të rregullave të higjienës të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë në faqen e internetit: www.salute.gov.it/nuovocoronavirus

PËRCAKTIMI I KONTAKTIT TË NGUSHTË

- Të jetosh **në të njëjtën shtëpi** me një **rast të konfirmuar me COVID-19**;
- Të keni qenë **në kontakt të afërt** (ballë për ballë) ose në të njëjtin mjedis të mbyllur me një rast të konfirmuar me COVID-19, për më shumë se 15 minuta, në një distancë më të vogël se 2 metra;
- **Operatori i kujdesit shëndetësor ose një person tjetër i punësuar për t'i ofruar ndihmë një rasti të konfirmuar** me COVID19 ose **personelit të laboratorëve** përgjegjës për të përpunuar mostrat e SARS-CoV-2.

Lidhja epidemiologjike mund të ketë ndodhur brenda një periudhe prej 2 ditësh më parë ose 14 ditëve pas fillimit të sëmundjes në rastit në fjalë.

NËSE NJË PUNONJËS REZULTON POZITIV ÇFARË DUHET TË BËJË KOMPANIA

në rast se një punëtor raporton se është pozitiv, në pritje të konfirmimit dhe marrjes përsipër nga ATS-ja, kompania duhet të përfshijë mjekun përgjegjës për verifikimin e çdo kontakti të afërt dhe ndërkohë, të marrë masat e përgjithshme të higjienës të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë dhe të disponueshme në faqen e internetit www.salute.gov.it/nuovocoronavirus dhe të vazhdojë me pastrimin e plotë të mjediseve të punës duke përdorur 0,1% hipoklorit natriumi ose 75% etanol.

ÇFARË DUHET BËRË PËR PUNONJËSIT QË PËRFUNDOJNË PERIUDHËN E KARANTINËS

I punësuari që ka rezultuar pozitiv dhe shtrohet në spital, në rastin kur del nga spitali merr udhëzime nga spitali për të mbajtur izolimin në banesë dhe nuk duhet të kthehet në vendin e punës deri në momentin kur rezultati i tamponit të kontrolluar të rezultojë negativ.

I punësuari i konsideruar kontakt i ngushtë i cili përfundon periudhën e karantinës pa simptoma mund të pranohet sërish në punë pa kontrole të mëtejshme.

I punësuari i konsideruar si kontakt i ngushtë që gjatë karantinës përjeton ethe dhe/ose simptoma të frymëmarrjes duhet të konsultohet me mjekun e përgjithshëm dhe të vazhdojë izolimin edhe për 14 ditë të tjera pas zhdukjes së simptomave. Në fund, VETËM PAS KONTROLLIT NGA MJEKU I PËRGJITHSHËM, ai mund të ripranohet të punojë pa kontrole të mëtejshme.

PËRDORIMI I MASKËS

Përdorimi i maskës ndihmon për të kufizuar përhapjen e virusit, por duhet të përdoret krahas masave të tjera për ruajtjen e distancës së sigurisë, higjienën e aparatit të frymëmarrjes dhe të duarve. Përdorimi i arsyeshëm i maskave është i rëndësishëm për të shmangur çuarjen dëm të burimeve të vlefshme. Nëse puna kërkon të punoni në një distancë ndër-njerëzore më pak se 1 metër dhe masat e tjera organizative nuk janë të mundshme, përdorimi i maskave dhe pajisjeve mbrojtëse (doreza, syze ..) është ende i domosdoshëm. Maska vendoset në mënyrën e duhur dhe për këtë jepen udhëzimet e përshtatshme për mënyrën e vendosjes (referoju http://www.salute.gov.it/portale/news/p3_2_1_1_1.jsp?lingua=italiano&menu=notizie&p=dalministro&id=4099).

SA KOHË MBIJETON KORONAVIRUSI I RI MBI SIPËRFAQET E NDRYSHME

Informacioni paraprak sugjeron që virusi mund të mbijetojë për një kohë të ndryshueshme në lloje të ndryshme të materialeve, por studimet janë ende në vazhdim. Përdorimi i dezinfektuesve të thjeshtë me bazë klori 1% (zbardhues) dhe alkooli 75% (etanol) mund të ngordhë virusin duke i hequr aftësinë e tij për të infektuar njerëzit.

RREGULLA PËR DEZINFEKTIMIN / LARJA E DUARVE

Larja dhe dezinfektimi i duarve janë çelësi për të parandaluar infeksionin. Duhet të lajmë duart shpesh dhe me kujdes me ujë dhe sapun për të paktën 60 sekonda. Sugjerohet që në tualete të vendosen udhëzime mbi mënyrat e duhura të larjes së duarve (referoju si shembull http://www.salute.gov.it/imgs/C_17_opuscoliPoster_340_allegato.pdf). Nëse mungon uji dhe sapuni si psh. në aktivitet pune në ambiente të jashtme të përdoret një dezinfektues për duar me bazë alkooli.

Në të gjitha ambientet e hapura për publikun, duhet të vihen në dispozicion të punonjësve si dhe të përdoruesve dhe vizitorëve solucione dezinfektuese për higjienën e duarve (neni 3 paragrafi 1 germa h e VKM-së dt. 8-3-2020).



MASA ORGANIZUESE PËR VEPRIMTARITË JO SHËNDETËSORE

DUKE MARRË TË MIRËQENË SE PUNËDHËNËSI DUHET TË VLERËSOJË RREZIQTET DHE TË PËRDORË MASAT PARANDALUESE TË NEVOJSHME PËRFSHIRË MENAXHIMIN E URGJENCIVE JEPEN UDHËZIME TË PËRGJITHSHME TË CILAT PËRSHTATEN SIGURISHT SIPAS KONTEKSTEVE TË VEÇANTA TË VENDIT TË PUNËS

Të kufizohen sa më shumë të jetë e mundur lëvizjet jo të domosdoshme

- të përkrahen **smart working dhe puna online** për të kufizuar kontaktet si në mjetet e transportit ashtu edhe në vendin e punës, si dhe për të mbështetur të punësuarit që kanë fëmijë të moshës shkollore (duke pasur parasysh mbylljen e shkollave);
- të shtyhen **veprimtaritë e detyrueshme** që kërkojnë lëvizje jashtë kompanisë (mbledhje, kurse etj.).

Të kufizohen sa më shumë lëvizjet jo të domosdoshme

- të kufizohen veprimtaritë me **kontakt të drejtpërdrejtë me përdoruesit sa më shumë që të jetë e mundur**;
- të shmangen **takimet** (> 3-4 njerëz) në vende të mbyllura dhe të jo të ajrosura mirë, ku nuk mund të garantohet distanca e sigurisë ndërmjet njerëzve (**të paktën 1 metër**), të përzgjidhen mënyra të komunikimit në distancë;
- të organizohen akseset në **vendgrumbullimet e zakonshme (p.sh. mencat, dhomat e zhveshjes, vendet e të ushqyerit dhe të pirit)** në mënyrë që të ulët numri i të pranishmëve, duke vendosur turne nëse është e nevojshme në mënyrë që ndërmjet njerëzve të respektohet distanca prej **të paktën 1 metër** midis njerëzve;
- të përdoren sa më shumë të jetë e mundur format e **komunikimit në distancë** (telekonferenca) edhe për të shmangur zhvendosjet e njerëzve dhe grumbullimet/konferenca/kurse në vende të mbyllura.

Veprimtaritë në zyrën e pritjes

- në veprimtaritë e **zyrës së pritjes** e janë të domosdoshme: nëse nuk është e mundur vendosja e barrierave fizike;
- të organizoni aktivitetin në mënyrë që të ruani distancën **të paktën 1 metër** nga përdoruesit;
- të organizohet fluksi i aksesit në sportele **duke shmangur krijimin e radhëve në ambiente**.

Të merret parasysh menaxhimi i vendeve dhe pajisjeve të punës

- të kontrolloni efikasitetin e **shkëmbimin e ajrit të sistemeve të ventilimit** në veçanti në hapësira të hapura dhe në dhoma pa ventilim natyral;

- nëse është e mundur të ajrosen ambientet nëpërmjet **hapjes së dritareve rregullisht**;
- të garantohet **pastrimi i vendeve të punës** në veçanti i pjesëve që përdoren bashkërisht (doreza, rubineta, tavolina shkrimi, tastiera, telefona) duke përdorur pastrues të lëngshëm me bazë alkooli ose klori;
- kompanitë e transportit publik duhet të marrin masa të jashtëzakonshme për pastrimin e automjeteve (sipas nenit. 3 paragrafi 1 germa l e VKM-së së datës 08-03-2020);
- rekomandohet gjithashtu pastrim rigoroz i automjeteve të kompanisë për përdorim të përbashkët.

NB: masat do të integrohen me dispozitat e VKM-së, si dhe ato të treguara në PROTOKOLLIN E PËRBASHKËT QË RREGULLON MASAT MBROJTËSE PËR KONTRASTIN DHE KONTROLLIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT COVID-19 NË VENDIN E PUNËS

çfarë duhet të bëjnë personat që kthehen nga jashtë shtetit në Itali

Të gjithë personat që kthehen nga jashtë edhe nëse janë asimptomatikë, janë të detyruar të njoftojnë menjëherë hyrjen e tyre në Itali pranë departamentit përkatës të parandalimit të ATS-së dhe ti nënshtrohen mbikëqyrjes shëndetësore e izolimit në mirëbesim për një periudhë prej 14 ditësh.

Për ATS Città Metropolitana të Milanos ekziston një seksion i dedikuar në faqen e internetit të kompanisë në lidhjen e mëposhtme <https://www.ats-milano.it/portale/EMERGENZA-CORONAVIRUS/RIENTRI-DALLESTERO-IN-ITALIA-CHE-FARE>.

Mbikëqyrja shëndetësore sipas dekretit legjislativ 81/08

Masat paraprake të mëposhtme duhet të ndiqen në mënyrë rigoroze: rregullimi i hyrjes në zyrën e mjekut vetëm pas kontaktit telefonik dhe me takim duke shmangur grumbullimin në dhomën e pritjes dhe duke shmangur grumbullimet në sallat e pritjes duke garantuar të paktën 1 metër distancë. Maska kirurgjikale duhet të jenë të disponueshme në sallën e pritjes (Shih udhëzimet e OBSH-së dhe indikacionet e dhëna nga DL 02/03/2020 nr. 9, neni 34 pika 3) dhe dezinfektues për duart.

Vizatat urgjente vazhdojnë të bëhen (pas kthimit pas 60 ditësh për shkak të sëmundjes ose karantinës, për ndryshimin e vendit të punës, sipas kërkesës në veçanti në prani të kushteve të prekjes ndaj infeksionit të koronavirusit): në këto raste, mjeku kompetent vlerëson këshillimin e kryerjes ose shtyrjes së vizitës në bazë të një interviste telefonike anamnestike.

Nëse nuk është e mundur të kryhet një mbikëqyrje shëndetësore në përputhje të rreptë me masat e përcaktuara të higjienës, ekzaminimet mjekësore periodike dhe ekzaminimet instrumentale mund të pezullohen për aq kohë sa masat për lëvizshmërinë dhe mbushjen e ambienteve do të jenë në fuqi, edhe në rast tejkalimi i periodicitetit të kërkuar nga programi i mbikëqyrjes shëndetësore.

INFORMACIONE TË MËTEJSHME

Për sektorët specifikë të punës, referojuni udhëzimeve në fuqi të Rajonit të Lombardisë, për shembull, atyre për veprimtaritë shëndetësore dhe socio-shëndetësore, veprimtaritë jo thelbësore, shërbimet publike themelore.

PËR INFORMACIONE TË MËTEJSHME MUND TË NA DREJTONI PYETJE NË ADRESËN E-MAIL:

dip19@ats-milano.it

Rekomandohen këto lidhje

Ministria e Shëndetësisë: www.salute.gov.it/nuovocoronavirus

Rajoni Lombardia: www.regione.lombardia.it/wps/portal/istituzionale/HP/servizi-e-informazioni/cittadini/salute-e-prevenzione/coronavirus

Instituti i Lartë i Shëndetit: www.iss.it

ESEM | CPT

ENTE UNIFICATO FORMAZIONE E SICUREZZA
Organismo Bilaterale Paritetico costituito da Assimpredil ANCE e Feneal UIL,
Ficca CISL, Fillea CGIL per le province di Milano Lodi Monza e Brianza

Sistema Socio Sanitario



**Regione
Lombardia**

**ATS Milano
Città Metropolitana**